

PROCESVERBAL
nga seanca e 14-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 9.4.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Goran Radunović, Cvetanka Mitrevska, Dimitar Tanurov, Ruzhica B. Jotevska, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 14-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 15:35 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Në lidhje me rendin e ditës të propozuar, kryetari Stefanovski sqaroi se Pika nr.2 - "Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë" – riemërtohet në "Propozim-aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetimit televiziv të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë", duke marrë parasysh se transmetuesi ndërkohë i ka përmbushur detyrimet e përcaktuara ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 13-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 2.4.2026.
2. Propozim-aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizion Plus ShPK Kumanovë.
3. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: organizimi i takimit të 65-të të EPRA-s.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 13-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 2.4.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, sqaroi Propozimin për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë. Në arsyetim, theksoi se transmetuesit, më 17 shkurt të këtij viti, iu dorëzua faturë për pagesën e kompensimit vjetor për transmetim televiziv në shumë prej 281.341,00 denarësh, e cila nuk ishte paguar në afatit e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh. Për shkak të mosveprimit sipas detyrimit, Këshilli, në seancën e mbajtur më 30 mars, inicoi procedurë për heqjen e lejes. Ndërkohë, më 9 prill, transmetuesi në tërësi e pagoi shumën në bazë të kompensimit vjetor, me çka i plotësoi kushtet ligjore për të paraqitur propozim në Këshill për ndalimin e procedurës për heqjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë, PA1 nr. 08-626 datë 09/07/2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-1326/2 datë 9.4.2026, ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë e pagoi plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetimit televiziv, sipas faturës së dorëzuar nr. 2026-100-0088 datë 17.2.2026.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, është i detyruar Aktvendimin për ndalimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Plus ShPK Kumanovë, ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi se materiali ishte objekt i shqyrtimi joformal, dhe deri në finalizimin e tij u dorëzuan vërejtje nga këshilltari Viktor Pavllovski. Të njëjtat, siç theksoi, u shqyrtuan në konsultim me Sektorin për çështje juridike dhe furnizime publike, ku u pranuan dhe u përfshinë në mënyrë të përshtatshme në tekstin e materialit të paraqitur në Këshill. Në lidhje me vetë procedurën, drejtori tregoi se sqarime shtesë mund të japë udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, ndërsa për përmbajtjen e materialit, anëtarët e Këshillit mund të kontaktojnë Ivana Stojanovskën ose Dragica Ljubevskën.

Dragica Ljubevska shpjegoi se ky është furnizim publik i shërbimit - përzgjedhja e operatori ekonomik i cili do të organizojë takimin e 65-të të Platformës Evropiane të Rregullatorëve (EPRA), i cili do të organizohet nga Agjencia. Takimi do të mbahet në periudhën nga 2 deri në 4 qershor 2027 në Shkup, me pjesëmarrjen e pritur rreth 150 deri në 180 të pjesëmarrësve vendas dhe të huaj. Ajo shpjegoi se furnizimi është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë duhet të zbatohet deri më 31 gusht 2026 dhe përfshin prodhimin e një videoje promovuese për vendin, furnizimin e dhuratave të vogla përfaqësuese dhe një dhurate protokollare, si dhe rezervimin e salle konferencash dhe akomodimit në hotel. Pjesa e dytë e furnizimit do të zbatohet në periudhën nga 1 maji deri më 4 qershor 2027 dhe përfshin sigurimin e një dhurate protokollare për mikpritësin e radhës të EPRA-s, blerjen dhe shtypjen e materialit promovues, sigurimin e dhuratave për pjesëmarrësit, organizimin e një takimi pune që zgjat një ditë e gjysmë me dreka dhe pauza kafeje të siguruara, organizimin e një pritjeje zyrtare më 2 qershor, darkë joformale më 3 qershor, si dhe organizimin e një turneu me grupe në Shkup që zgjat afërsisht dy orë. Ai gjithashtu theksoi se si shtojcë e materialit është dorëzuar specifikim teknik i detajuar dhe se lënda e kontratës është e pandashme,

përkatësisht operatori ekonomik duhet të përfshijë të gjitha elementet e specifikimit, përndryshe oferta do të konsiderohet e papranueshme. Furnizimi, siç theksoi ai, është parashikuar në Planin Financiar Vjetor dhe Planin për furnizime publike të Agjencisë për vitin 2026.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, shtroi pyetje në lidhje me prodhimin e videos promovuese, përkatësisht nëse është parashikuar ofertuesit të paraqesin skenar për realizimin e tij.

Mr. Dragica Ljubevska u përgjigj se në kuadër të procedurës, parashikohet që operatori ekonomik të paraqesë skenar, i cili pas miratimit të tij do të pasohet nga një version pune, dhe pas pranimit të tij, do të fillojë prodhimi i versionit përfundimtar të videos.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi se ky është furnizim i parashikuar në Planin Vjetor për furnizime publike, për të cilin mjetet janë siguruar në Planin Financiar të Agjencisë. Sipas vlerës së parashikuar, procedura do të kryhet si procedurë e hapur, në përputhje me Ligjin për furnizime publike. Ajo shpjegoi se procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizime publike, si dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", nga ku të gjitha informacionet e mbetura relevante janë detajisht të elaboruara në materialet e dorëzuara. Njëkohësisht theksoi se shërbimi profesional është në dispozicion për sqarime shtesë.

Në vazdim, kryetari Stefanovski shtroi pyetje në lidhje me strukturën financiare, përkatësisht nëse fondet e parashikuara përfaqësojnë shumën maksimale që Agjencia do të shpenzojë për këtë qëllim.

Drejtori Trajçevski u përgjigj pozitivisht, duke shpjeguar se bëhet fjalë për shumë maksimale të parashikuar, me vlerën përfundimtare që varet nga ofertat e paraqitura në kuadër të procedurës për furnizim publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: organizimin e takimit të 65-të të EPRA-s.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik-të shërbimit: organizimi i takimit të 65-të të EPRA-s, është planifikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (tekst i pastruar) nr. 05-869/1 datë 4.3.2026, dhe fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr.Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani

